



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Krenar Ryci, Nikolin Staka, Ervin Bushati, Reme Lala, Artur Roshi, Artemis Dralo (Malo), Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Edlira Hyseni dhe Anastas Angjeli.

Të ftuar:

Brikena Jazxhi- Sektori I Huamarrjes.

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëdita!

Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”.

I kërkoj sekretarit të Komisionit dhe shërbimeve të Kuvendit që të dërgojnë një letër zyrtare në emrin tim tek të gjitha ministratë, por edhe Kryeministrit dhe shefes së kabinetit për dijeni, se kjo është hera e fundit që unë bëj mbledhje komisioni, dhe të gjitha ligjet do të kthehen pas, në qoftë se ministri ose zëvendësministri nuk do të jetë prezent në mbledhjet e komisionit. Dua të bëni një letër zyrtare që ta firmos sot.

Faleminderit!

Kemi të ftuar Brikenën.

Fjalën e ka relatorja, Antoneta Dhima.

Faleminderit!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Ekonominë dhe Financat javën e kaluar shqyrtoi dhe miratoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”, që është miratuar në seancën plenare. Përmes këtij ligji, që përfaqëson marrëveshjen bazë qeveritare, dy qeveritë kanë rënë dakord për dhënien e mundësisë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë një kredi të butë në vlerën 40 milionë euro dhe një grant në vlerën 2 milionë euro.

Projektligji që po shqyrtojmë sot është në zbatim të kësaj marrëveshjeje, duke konkretizuar dhe përcaktuar në terma konkretë kushtet e kësaj huaje. Ai synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet dy qeverive, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit të furnizimit me ujë në zonat rurale. Gjithashtu, do të mundësohet vënia në punë e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Orikum, instalimi i lidhjeve familjare ...

Arben Ahmetaj – Zonja Dhima, sa më shkurt, sepse ne e kaluam me Ministrinë e Infrastrukturës marrëveshjen.

Antoneta Dhima – Dakord.

Pothuajse janë të njëjtat kritere që ishin edhe në marrëveshjen e mëparshme, të cilën ne e miratuam. Norma fikse e interesit do të përcaktohet në momentin e bërjes efektive të huas. Për sa u përket termave të tjerë financiarë të dakordësuar në marrëveshje, rezulton se tarifa e menaxhimit do të jetë në masën 1% të shumës së huas, tarifa e angazhimit do të jetë 0,25% në vit për shumat e padisbursuara të huas dhe do të jetë e kërkueshme për pagesë çdo vit në bazë 6-mujori. Maturimi i huas do të jetë për 15 vjet, duke përfshirë periudhën 3 vjet pa pagesë principali. Afati i disbursimit të huas është deri në 30.3.2024.

Kostoja totale e projektit “Furnizimi me ujë në zonat rurale IV” vlerësohet të jetë 45,15 milionë euro, pa përfshirë vlerën e TVSH-së apo taksa të tjera që lindin nga projekti, që do të mbulohen nga buxheti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, kosto e cila do të financohet nga huaja në fjalë në vlerën 40 milionë euro, buxheti i shtetit në vlerën 1,35 milionë euro, granti që do të akordohet nga KfW-ja në vlerën 2 milionë euro dhe granti që do të akordohet nga WBIF në vlerën 1,8 milionë euro. Projekti është parashikuar në programin afatmesëm 2019-2021 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, konkretisht në programin “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Për sa thashë më sipër, i propozoj komisionit që ta miratojmë këtë aktmarrëveshje.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Nga ministria ka ndonjë gjë specifike për të thënë, pa lexuar relacionin?

Brikena Jazxhi – Në fakt, gjithë sa përmendi zonja deputete ishte një përmbledhje e detajuar e projektit. Ky program vjen në vijim të tri fazave të mëparshme, të cilat, gjithashtu, janë zbatuar me sukses nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Faza e tretë sapo ka filluar, kurse faza e parë dhe e dytë kanë përfunduar. Paketa e financimit që vjen nga KfW-ja është me terma shumë të favorshëm, duke qenë se shoqërohet edhe me grante në vlera të konsiderueshme, grante të qeverisë gjermane dhe fonde të BE-së, WBI-së.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje apo koment?

Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin në parim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me miratimin nën për nën të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”.

Neni 1.

Ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt *am Main* (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV me një hua në shumën 40 milionë euro”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit përfaqësuesve të ministrisë!

Lajmëroni ministren zyrtarisht në emër të kryetarit të Komisionit që herë tjetër nëse nuk do të vijë vetë ose do të dërgojë një zëvendësministër, do t’i kthehen pas të gjitha ligjet.

Brikena Jazxhi – Kërkoj ndjesë!

Arben Ahmetaj – Nuk dua shpjegim nga ju.

Brikena Jazxhi - Dua të them që zëvendësministri është nisur për të ardhur. Ndoshta

...

Arben Ahmetaj – Pse nuk erdhi në orën 10:45? Çfarë takimi më të rëndësishëm se ky kishte? Çdo të thotë? Ditë e hënë, Kuvendi. Çfarë shpjegimi do të më japësh?

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti